



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “ MIHAL SHAHINI ” CERRIK**

Nr. 378 prot.

Cerrik, më 16.09.2025

Lënda: Shpallje e vendit të lirë me kohë të pjesshme

Drejtuar : **AGJENCISË KOMBETARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE (AKPA)**

Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore

Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun

TIRANE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “ Për nxitjen e punësimit ” ; të ligjit nr. 15/2017, “ Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ”; të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 554 , datë 31.7.2019 , “ Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive ” ; të Udhëzimit Nr.759, datë 30.09.2024 , “ Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit profesional si dhe aspekte të menaxhimit të burimeve , përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit ”,

Ofruesi publik i AFP-së , Shkolla e Mesme Profesionale ”Mihal Shahini ” Cerrik , ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

1 (një) Instruktor i praktikave profesionale me kohë të pjesshme në drejtimin Bujqësi .

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posacme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas të mesëm, në fushën/profesionin e kursit/kurseve të formimit profesional , për të cilin po aplikon ;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën , në të cilën është kualifikuar ;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.
- d) Aftësi të tjera nëse kërkohen.

2.Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar , sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë :

- a) letërmotivimin për pozicionin ;
- b) jetëshkrimin (CV-në);
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën ;
- e) librezën e punës ;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet , trajnimet apo të tjera të përmendura në CV ;
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit ;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore ;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore ;
- j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit , që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi ;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre .

Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda datës 26.09.2025

3. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 759, datë 27.5.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e

njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, i ndryshuar.

DREJTOR I SHKOLLËS

ERINA DISHO

